




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Radiostacioni Lokal "Radio Dodona"
Numri i biznesit - 80186479
Pronar – Ekrem REXHEPI
Radio Dodona
Drenas

"Tau-Gen-Ingjiniering" Sh.p.k
Numri i biznesit - 70459470
Pronar – Ilaz ÇOLLAKU
Prishtinë

Ref: 1905/572/LIC/ni

VENDIM

lidhur me ndryshimin e pronësisë të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio Radio Dodona – me seli në Drenas

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Dodona është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio (radio) me mbulim lokal, i cili është i licencuar nga KPM për të transmetim tokësorë të radio programeve në komunën e Drenasit. Radio Dodona është pajisur nga KPM, me licencë afatgjatë të transmetimit me datën 28 gusht 2009 dhe e njëjta i është ripërtërirë, në pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së, edhe për shtatë (7) vite, që nënkupton se licenca e Radio Dodona është e vlefshme deri më 28 gusht 2023.
3. Me datën 1 shkurt 2019, Radio Dodona ka dorëzuar në zyrën e KPM-së, një kërkesë për ndryshimin e pronësisë së radio stacionit, përmesë së cilës është kërkuar që të kalohet pronësia nga biznesi Radiostacioni Lokal "Radio Dodona", numri i biznesit 80186479 me pronar z. Ekrem Rexhepi, tek, biznesi "Tau – Gen - Ingjiniering" Sh.p.k., numri i biznesit – 70459470, me pronar z. Ilaz Çollaku.

Arsyetim

4. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
5. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
6. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
7. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë së Radio Dodona thuhet se, arsyeja për ndryshimin e pronësisë është interesimi pronarit aktual për tu marr me veprimtari tjera biznesore.
8. Kërkesa për ndryshim të Licencës së KPM-së nuk përbënë edhe ndryshimin e skemës programore dhe parametrave teknik të licencës.
9. Kandidati i propozuar për pronar të ri ka shprehur gatishmëri që, ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
10. Kandidati i propozuar për pronar të ri përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka paraparë investime në teknologjinë e transmetimit të Radio Dodona në mënyrë që transmetimi i programit të jetë më kualitativ.
11. Kandidati për pronar të Radio Dodonës, si pjesë e kërkesës për ndryshim të pronësisë ka bashkangjitur edhe dëshmi nga banka sa i përket qëndrueshmërisë financiare.
12. Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio Dodona nuk do të ndikojë në ndryshimin e zonës së mbulimit.
13. Paraprakisht Radio Dodona ka shlyer të gjitha obligimet e saja financiare ndaj tarifës vjetore të licencës së KPM-së dhe obligimeve tjera financiare si dhe ka kryer pagesën e tarifës administrative për ndryshim të licencës, në pajtueshmëri me aktet nënligjore të KPM-së.
14. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

VENDIM

15. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 26 prill 2019, merr vendim për ndryshimin e pronësisë së Radio Dodona dhe ta transferoj Licencën e KPM-së nga biznesi Radiostacioni Lokal “Radio Dodona”, me numër të biznesit 80186479 me pronar z. Ekrem Rexhepi, tek, biznesi “Tau – Gen - Injinierring” Sh.p.k., numër të biznesit –

70459470, me pronar z.Ilaz Çollaku dhe në bazë të këtij vendimi të ndryshohet edhe licenca e Radio Dodona.

16. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI
Kryetar
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



06.05.2019
datë